



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Shkurt, 2025

01-28 shkurt, 2025

PËRMBAJTJA E
BULETINIT

- 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit shkurt 2024 dhe 2025
- 2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
- 3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
- 4. Epidemitë e lajmëruara
- 5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
- 6. COVID-19
- 7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA
SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT SHKURT
2025 DHE 2024

Gjatë muajit shkurt 2025 janë raportuar **28,523 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(1,600.51 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2024 (18,969 raste ose Inc 1,064.41 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Influenca sezonale (ILI) me 22,449 raste ose 1,259.68/100,000 banorë, Sindroma diareale me 4,094 raste ose 229.73/100,000 banorë, dhe ARI/ITPR me 1,104 raste ose 61.95 në 100,000 banorë (Tab.1).**

Gjatë muajit shkurt 2025 janë raportuar 9 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 3 raste me dg. Meningoencephalitis acuta me diagnozë përcjellëse, 3 raste dg Bronchopneumonia me diagnozë përcjellëse, 1 rast me Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse, 1 rast me dg. Gastroenterocolitis acuta me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me COVID-19 me diagnozë përcjellëse.

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, SHKURT 2025

Gjatë muajit shkurt 2025 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me numrin më të lartë, (shih Tabela 1)

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit shkurt 2025 në IKShPK janë raportuar 22,449 raste me ILI (Inc. 1,259.68/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rritje prej 67.79% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (13,379 raste) por krahasuar me muajin paraprak, janar 2025 me (32,331 raste të raportuara me ILI) vërehet ulje prej 30.56%, karakteristike kjo për sezonën dhe aktivitet të lartë të qarkullimit të patogjenëve respirator.

Sindroma diareale: Gjatë muajit shkurt 2025 në IKShPK janë raportuar 4,094 raste me sindromë diareale (Inc. 229.73/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (3,294 raste), vërehet një rritje prej 24.28% por krahasuar me muajin janar 2025, me 5,751 raste të raportuara, ulje prej 28.81%. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë.

ARI/ITPR: Gjatë muajit shkurt 2025 në IKShPK janë raportuar 1,104 raste me ARI (Inc. 61.95/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,360 raste) vërehet një ulje prej 18.82% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak janar 2025 me (2,350 raste) të raportuara, ulje prej 53.02%.

Variçella: Gjatë muajit shkurt 2025 në IKShPK janë raportuar 331 raste me Variçellë (Inc. 18.57/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (655 raste) vërehet rënie prej 49.46% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak janar 2025 me (563 raste), rënie prej 41.20%.

**Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë,
01 – 28 shkurt të vitit 2024 dhe 2025**

Tabela 1.

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë në periudhën 01 - 28 shkurt të vitit 2024 dhe 2025				
Sëmundjet	Shkurt, 2024		Shkurt, 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100.000	Nr.	Incidenca/100.000
COVID-19	18	1.01	6	0.34
ITPR - Pneumonia/ARI	1360	76.31	1104	61.95
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	25	1.40	11	0.62
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	13379	750.74	22449	1259.68
Influenca A	51	2.86	72	4.04
Influenca B	2	0.11	215	12.06
RSV	17	0.95	35	1.96
Sindroma diareale	3294	184.84	4094	229.73
Varicela	655	36.75	331	18.57
Sindromi meningjeal	16	0.90	10	0.56
EHSV		0.00	1	0.06
Helmimet me ushqim	55	3.09	14	0.79
Salmonella enteritidis	4	0.22	1	0.06
Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale me Rotavirus	2	0.11	4	0.22
Gastroenterokolitet	19	1.07	48	2.69
Adenovirus	1	0.06		0.00
Clostridium difficile			2	0.11
Hepatiti akut A	1	0.06	1	0.06
Hepatiti akut B	1	0.06	2	0.11
Hepatiti akut C		0.00	2	0.11
Morbilli		0.00		0.00
Parotiti epidemik	2	0.11	1	0.06
Pertussis	6	0.34	5	0.28
TB		0.00	24	1.35
Tularemia	1	0.06	1	0.06
Brucellosis	1	0.06	2	0.11
Sëmundja Lyme	2	0.11		0.00
Toxoplasmosis	2	0.11	1	0.06
HIV	2	0.11	3	0.17
IST	32	1.80	20	1.12
Infeksionet streptokoksike të gr. A		0.00	11	0.62
Giardiaza	7	0.39	4	0.22
*Sëmundjet tjera ngjitëse	14	0.79	49	2.75
Gjithsej	18969	1064.41	28523	1600.51
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza				

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:**Sëmundjet vaksinëpreventabile:**

Gjatë muajit shkurt 2025, nga gjithsej 4 raste të testuara si raste të dyshimta me Parotit nga laboratorit mikrobiologjik i IKSHPK-së, është konfirmuar 1 rast pozitiv. Rasti është nga komuna e Drenasit dhe i takonë gjinisë femërore me status të rregullt vaksinal.

Gjatë muajit shkurt 2025, nga gjithsej 10 raste të testuara si raste të dyshimta me Pertussis, nga laboratorit mikrobiologjik i IKSHPK-së janë konfirmuar 5 raste pozitive, prej të cilëve 3 prej tyre kanë status të rregullt vaksinal. Rastet e konfirmuara sipas komunave: Prishtinë (4 raste) dhe Istog (1 rast). Sipas grup-moshës: 2-4 vjeç (1 rast), 5-9 vjeç (1 rast), 10-18 vjeç (2 raste) dhe mbi 18 vjeç (1 rast). Sipas gjinisë 3 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 2 raste i takojnë gjinisë mashkullore.

Gjatë muajit shkurt 2025, nga gjithsej 11 raste të testuara si raste të dyshimta me Morbill, nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise:

Gjatë muajit shkurt nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar 2 raste me Brucellozë, 1 Tularemi, 1 Toxoplasmozë dhe 1 rast me EHSV.

Sipas komunave me Brucellozë (2 raste janë nga Prizreni), rasti me Tularemi është nga komuna e Vushtrrisë dhe rasti me Toxoplasmozë është nga Prishtina. Të katër rastet i përkasin gjinisë mashkullore. Sipas grup-moshës, rastet me Brucellozë i takojnë asaj 10-19 vjeç (2 raste), me Tularemi 50-59 vjeç dhe rasti me Toxoplasmozë nga grup-mosha 50-59 vjeç.

Sipas hulumtimit epidemiologjik: Rastet me Brucellozë, nga Prizreni, janë raste sporadike dhe pa ndonjë lidhshmëri me njëra tjetrën, rasti i parë është familjar i pronarit të një ferme delesh, lopësh dhe kuajsh, ndërsa rasti i dytë mbron kontaktin me kafshë. Për rastet është njoftuar AUV.

Rasti me Tularemi, me profesion inxhinier i elektromekanikës, i është ekspozuar pajisjeve-makinerve të cilat ishin të ndotura me jashtëqitje të brejtësve, i cili pas konsultës udhëzohet për hospitalizim në klinikën Infektive.

Gjatë muajit shkurt 2025 është raportuar 1 rast me Hantan virus, nga komuna e Prizrenit (punëtor në pompë të benzinës), i gjinisë mashkullore dhe i takon grup moshës 50-59 vjeç. Rasti deklaron se nuk ka qëndruar në ndonjë bjeshkë nga vendet endemike të Kosovës dhe mbron prezencën e brejtësve në vendbanimin e tij.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit shkurt, 2025 janë raportuar 10 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.56/100 000 banorë), prej tyre 5 raste me Meningjit akut viral, 5 raste me Meningjit bakterial. Ky numër i rasteve të raportuara është pak më i ulët, krahasim me muajin janar, 2025, ku janë raportuar 14 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.78/100 000 banorë).

Sipas komunave, me nga 2 raste janë raportuar në komunat: Prishtinë, Prizren dhe Podujevë, dhe me nga 1 rast komunat Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Lipjan, kurse Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komuna e Podujevës dhe Lipjanit me 2/100,000 banorë.

Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 60-69 vjeç 30%(3 raste), grup- mosha 0-9 vjeç me 20%(2 raste), kurse gru- moshat 10-19 vjeç, 20-29 vjeç, 30-39 vjeç, 40-49 vjeç dhe 50-59 vjeç me nga 10% (1 rast) të raportuar.

Sipas gjinisë, rezulton se 70% (7 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe 30% (3 raste) gjinisë femërore.

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 7 shkaktarë në LCS, prej tyre: 4 raste Streptococcus pneumonia, 1 rast me HHV 1, 1 rast me HHV7 dhe 1 rast me Enterococcus faecalis.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit shkurt 2025 janë raportuar 48 raste me Gastroenterokolit, 14 raste me Helmim me ushqim dhe 1 rast me Hepatit A.

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar: 1 rast me Salmonellë, nga komuna e Malishevës, e gjinisë femërore dhe i takon grup moshës 0-9 vjeç, 4 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Prishtinë, 1 rast Gjakovë dhe 1 rast Prizren. Të gjitha rastet janë të grup moshës 0-9 vjeç, ndërkaq sipas gjinisë 2 raste janë të gjinisë mashkullore dhe 2 raste të gjinisë femërore, 2 raste me Clostridium difficile, prej të cilave sipas komunave janë: 1 rast Prishtinë dhe 1 rast Obiliq. Sipas grup moshave 1 rast i grup moshës 0-9 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 60-69 vjeç, ndërkaq sipas gjinisë 1 rast është i gjinisë mashkullore dhe 1 rast i gjinisë femërore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit shkurt 2025 janë testuar 661 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Prej tyre, 446 (67.47%) mostra të testuara nga qendrat sentinel dhe 215 (32.52%) nga qendrat jo sentinel.

Nga mostrat e testuara janë konfirmuar 287 raste me Influcencën A dhe B apo pozitivitet prej 43.41%. Sipas tipit: Influcencë A (72 raste apo 10.89%) dhe Influcencë B (215 raste apo 32.52%).

Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 35 (5.29%) mostra pozitive me RSV, 59 (8.92%) mostra pozitive në Human Rhinovirus, 27 (4.08%) mostra pozitive në Human Adenovirus dhe 15 (2.26%) mostra pozitive në Metapneumovirus.

Mbikëqyrja me Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC, WHO për sezonën 2024/2025 si dhe Buletin javor për Influcencë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike.

Rastet pozitive në Influcencë A dhe B i përkasin komunave : Mitrovice (128 raste), Prishtinë (79 raste), Fushë Kosovë (13 raste), Vushtrri (9 raste), Lipjan (7 raste), Podujevë (6 raste), Drenas (5 raste), Ferizaj (6 raste), Malishevë (3 raste), Skenderaj (5 raste), Prizren (5 raste), Pejë (5 raste), Suhareke (3 raste), Gjilan (3 raste), Obiliq (2 raste), Gjakove (2 raste) dhe me nga nje rast komunat : Deqan, Rahovec, Shtime, Viti, Kline dhe Hani Elezit.

Rastet pozitive në virusin sincial (RSV) sipas komunave dhe grupmoshës : Prishtinë (13 raste), Pejë (3 raste), Ferizaj (2 raste), Kaçanik (2 raste), Malishevë (2 raste), Shtime (2 raste), Podujevë (2 raste) dhe me nga nje rast komunat : Deqan, Drenas, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Klinë, Mitrovicë, Skënderaj dhe Suharekë.

Influenca A dhe B është raportuar nga pothuajse të gjitha komunat ku sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës dhe Mitrovicës, ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Mitrovicës, Prishtinës dhe Fushë Kosovës.

Sipas grupmoshës, me Influcencë A dhe B : grup-mosha 0-4 (125 raste), 5-14 (100 raste), 15-34 (29 raste), 51-64 (18 raste), 35-50 (11 raste) dhe grup-mosha 65+ (4 raste). Prej 287 rasteve pozitive me Influcencë A dhe B, 24 prej tyre të hospitalizuar në Kl. Infektive.

Gjatë muajit shkurt 2025, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse, u raportuan gjithsej 11 raste me SARI. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-

CoV-2, Influenca dhe RSV. Prej tyre 2 pacientë rezultuan pozitiv në virusin sincicial (RSV), 1 pozitiv në Metapneumovirus (MPV), 1 pozitiv në Human Adenovirus (ADV) dhe 1 pozitiv në Human Rhinovirus (HRV), ndërsa të gjithë pacientët tjerë rezultuan negativ në Sars-COV-2 dhe Influcencë.

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (3 raste), Ferizaj (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Drenas, Fushë Kosovë, Kaçanik, Rahovec, Gjakovë dhe Vushtrri. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : 0-4 vjeç (4 raste), mbi 65 vjeç (3 raste), 51-64 vjeç (2 raste) dhe 5-14 (2 raste). Sipas gjinisë, 6 prej tyre i takojnë gjinisë femërore dhe 5 gjinisë mashkullore.

Gjatë muajit shkurt 2025, përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse nga 6 komuna janë raportuar 24 raste me TB (Inc.1.35/100,000 banorë) shih Tabela 1 dhe 2.

Rastet me HIV/AIDS/IST, shkurt 2025

Gjatë muajit shkurt 2025, janë raportuar 3 raste me HIV/AIDS. Dy raste i takojnë gjinisë mashkullore, komuna e Prishtinës, grup moshë 25-34 vjeç dhe 55+, komuniteti MSM. Rasti i tretë është po ashtu komuna e Prishtinës, gjinia femërore grup moshë 35-44 vjeç Rasti është raportuar përmes SMSN.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), shkurt 2025

Gjatë muajit shkurt 2025 janë raportuar gjithsej 20 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Pejë 9, Prishtinë 7, Podujevë 2, Prizren 1 dhe Gjilan 1. Sipas diagnozës: Chlamydia 8 raste, Condyloma 8 raste, Gonorreja 3 raste dhe Sifiliz 1 rast. Sipas gjinisë: 11 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 9 raste gjinisë mashkullore. Grup moshës 25-49 vjeç i takojnë 14 raste, grup moshës 15-24 vjeç (2 raste) dhe mbi 50+ vjeç (4 raste). Shtatë raste janë raportuar përmes SMSN, nga ana e Klinikës së Dermatovenerologjisë, një rast po ashtu nga ana e Kl. Infektive me SMSN, dy raste janë raportuar me anë të "Formës së raportimit" me dorë nga ana e QMF Mati I, nëntë raste janë raportuar nga ana e laboratorit privat në Pejë me anë të postës elektronike, dhe një rast është raportuar nga ana e Repartit të Dermatovenerologjisë me anë të postës elektronike.

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C, shkurt 2025

Gjatë muajit shkurt 2025, janë raportuar 2 raste me Hep. ac. B (Prishtinë 54 vjeç, femër dhe Shtime 60 vjeç, femër) dhe 2 raste me Hepatit ac. C (Prishtinë 30 vjeç, mashkull dhe Ferizaj 53 vjeç, mashkull).


3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT SHKURT 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, diaretë akute dhe gastroenterokolitët nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga rastet tjera të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit shkurt 2025

Tabela 3.

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	174
SARI	10
COVID-19	1
Diare dhe gastroenterokolitët	118
Salmonelloza	3
Sindroma meningjeale	10
Hepatitis B	2
Helmimet me ushqim	7
Status febrilis	15
Mononucleosis	7
Erysipela	4
Total	351



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT SHKURT, 2025

Gjatë muajit shkurt 2025, nuk është raportuar asnjë epidemi.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE


*Për këtë periudhë, kanë raportuar 31 komuna ose 81.57% (31/38) e tyre.
Komunat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Kllokot, Mitrovicë e veriut,
Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.*

6. COVID-19

Gjatë muajit shkurt 2025, janë testuar 844 mostra të dyshimta në COVID-19 dhe 6 prej tyre kanë rezultuar pozitive me SARS-CoV-2 dhe shkallë të pozitivitetit prej 0.71%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 (18 raste pozitive të raportuara), vërehet ulje e rasteve pozitive. Gjatë muajit shkurt 2025 gjithashtu është raportuar një rast i vdekjes nga COVID-19 me CFR (16.6%), rast i gjinisë mashkullore mbi 65 vjeç dhe sëmundje përcjellëse. (Grafikoni 1). Rastet pozitive, sipas komunave: Prishtinë (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Podujevë, Vushtrri, Istog dhe Lipjan. Sipas gjinisë 4 raste i takojnë asaj mashkullore dhe 2 raste gjinisë femërore ndërsa sipas grup-moshave: 70-79 vjeç (2 raste) dhe me nga një rast grup-moshat: 10-19, 30-39, 50-59 dhe 60-69 vjeç.

Në Kosovë varianti i SARS-CoV-2 Omicron BA.2.86 dhe subvariantet e tij, përfshirë KP.3, dominojnë në mesin e mostrave të testuara pozitive në virusin SARS CoV-2, në periudhën një-mujore nga 10 Korrik deri 9 Gusht 2024. Nga variantet kemi: 53% për Variantin KP.3 (44 detekttime) dhe 47% për Variantin BA.2.86 (39 detekttime). Rrjedhimisht, prania e nën-linjave të variantit të Omicronit të SARS-CoV-2 në Kosovë është në përputhje të përafërt me epidemiologjinë virologjike të SARS-CoV-2 në vendet tjera Europiane, përkatësisht me dominim të variantit KP.3. Aktiviteti i SARS-CoV-2 ka pësuar një rënie, me nivele pozitiviteti më të ulëta krahasuar me vitin 2023. Situata mbetet e ndryshme në nivel të të gjitha shteteve raportuese, me individët mbi 65 vjeç më të prekur nga sëmundjet e rënda të COVID-19

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, shkurt 2025



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, JANAR 2025

Fruthi në rritje përsëri në Evropë: koha për të kontrolluar statusin tuaj të vaksinimit

Të dhënat e paraqitura në përditësimin mujor të fruthit dhe rubeollës nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) tregojnë transmetimin e vazhdueshëm të fruthit në një numër vendesh në BE/EEA, me një rritje të madhe të rasteve të raportuara gjatë vitit 2024. Ndërmjet 1 shkurtit 2024 dhe 31 janarit 2025, gjithsej 32,265 persona u diagnostikuan me fruth. Gjatë kësaj periudhe, Rumania (27,568), Italia (1,097), Gjermania (637), Belgjika (551) dhe Austria (542) raportuan numrin më të madh të rasteve në të gjithë BE/ZEE. Gjatë kësaj periudhe, Rumania regjistroi 18 vdekje nga fruthi dhe Irlanda gjithashtu regjistroi një vdekje.

Transmetimi i vazhdueshëm tregon boshllëqe në mbulimin e vaksinimit kundër kësaj sëmundjeje të parandalueshme - midis fëmijëve, adoleshentëve dhe të rriturve. Fruthi është një sëmundje shumë ngjitëse. Ai transmetohet lehtësisht nga personi në person përmes ajrit (për shembull, kur një person i infektuar kollitet ose teshtin) dhe përhapet me shpejtësi në komunitetet midis njerëzve që nuk janë vaksinuar ose nuk janë imunizuar plotësisht. Në vitin 2024, kulmi i rasteve të fruthit të raportuar në të gjithë BE/ZEE u vu re në gjashtë muajt e parë të vitit. Në përputhje me modelin sezonal të sëmundjes, një rritje e mëtejshme e numrit të rasteve pritet gjatë pranverës së vitit 2025.

Rekomandimet për të rriturit dhe prindërit/kujdestarët janë të kontrollojnë statusin e vaksinimit: sigurohuni që ju dhe fëmijët tuaj të jeni të përditësuar me dozat e vaksinës MMR, pavarësisht nëse qëndroni në shtëpi ose planifikoni të udhëtoni; jini të vetëdijshëm për simptomat tipike të fruthit (si një profesionist i kujdesit shëndetësor dhe një pacient i mundshëm). Fruthi mund të çojë në komplikime të rënda duke përfshirë pneumoni, encefalit dhe madje edhe vdekje.

Përhapja e Salmonellës në Bashkimin Evropian/Zonën Ekonomike Evropiane

Midis janarit 2023 dhe janarit 2025, 509 persona u raportuan me salmonelozë në nëntë vende të BE/ZEE. Vendi më i prekur ishte Norvegjia, me 257 raste, e ndjekur nga Suedia, Finlanda dhe Gjermania. Përhapja është e vazhdueshme dhe rastet e salmonelozës mund të vazhdojnë të gjenden derisa pika(at) ku farat e mbjellura janë kontaminuar, do të identifikohen dhe kontrollohen siç duhet.

Hulumtimet epidemiologjike kanë konfirmuar se farat e mbjellura janë shkaku i këtyre infeksioneve. Si rezultat i hulumtimeve epidemiologjike, duke përfshirë analizën e sekuencës gjenomike të plotë dhe gjurmimin e ushqimit, farat u lidhën me një furnizues të vetëm në Itali, i cili i merrte farat nga tre kultivues në të njëjtin rajon. Megjithatë, hulumtime të mëtejshme për të përcaktuar se si farat u kontaminuan dhe nëse kishte ndonjë kontaminim të kryqëzuar përgjatë zinxhirit të furnizimit. Ky shpërthim ka përfshirë shtame të shumta Salmonella, disa prej të cilave janë parë rrallë në Evropë. Duke ndarë informacionin nga hetimet kombëtare të shpërthimit në nivel BE, veçanërisht të dhënat e sekuencës së gjenomit të plotë, ishte e mundur të lidheshin hetimet me një burim të vetëm. Salmonela mund të shkaktojë sëmundje serioze, veçanërisht tek foshnjat, të rriturit e moshuar ose të dobët dhe individët me sistem imunitar të dobësuar. Ata që janë në rrezik duhet të shmangin ngrënien e farave, përveç nëse ato janë gatuar plotësisht. Prodhuuesve të farave u kërkohet të ndjekin me përpikëri procedurat e sigurisë ushqimore për të parandaluar që produktet e kontaminuara të arrijnë te konsumatorët.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSH sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontroll të sëmundjes. (gjatë muajit shkurt 2025 përmes SMSN janë raportuar 409 raste të sëmundjeve ngjitëse).

Në vitin 2024, kulmi i rasteve të fruthit të raportuara në të gjithë BE/ZEE u vu re në gjashtë muajt e parë të vitit të këtij viti. Në përputhje me modelin sezonal të sëmundjes, një rritje e mëtejshme e numrit të rasteve pritet gjatë pranverës së vitit 2025.

Rekomandimet për punëtorët shëndetësorë, ngritje e vigjilencës, ndërsa për të rriturit dhe prindërit/kujdestarët të kontrollojnë statusin e vaksinimit: sigurohuni që ju dhe fëmijët tuaj të përditësoheni me dozat e vaksinës MMR, pavarësisht nëse qëndroni në shtëpi ose planifikoni të udhëtoni; jini të vetëdijshëm për simptomat tipike të fruthit (si një profesionist i kujdesit shëndetësor dhe një rast i mundshëm). Fruthi mund të çojë në komplikime të rënda duke përfshirë pneumoni, encefalit dhe madje edhe vdekje.

Sëmundjet zoonotike dhe ato që përcillen nga vektorët në Kosovë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe po ndryshojnë pasqyrën e ngarkesës nga sëmundjet ngjitëse, prandaj rekomandojmë fuqizim të bashkëpunimit ndërsektorial dhe themelimin e komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet”.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË

PUBLIKE TË KOSOVËS

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000

WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>

E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net

Telefoni+38338 551432, ext. 1013



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS
NATIONAL INSTITUTE OF PUBLIC HEALTH OF KOSOVA